



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 71.
Prishtinë, më 26.06.2013 në ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Glauk Konjufca, Goran Marinkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic, Rasim Demiri dhe Mursel Halili.

Munguan: Elmi Reçica, Lirije Kajtazi dhe Mufera Sinik.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuese e OSB-së, Lejla Selimi, përfaqësues nga IND- ja Xhemajl Jashari, përfaqësuese nga Ambasada Britanike Miranda Shala, përfaqësuese e ECMI (Qendra Evropiane për çështje të minoriteteve në Kosovë) Lyra Pollozhani, përfaqësues i organizatës së OHCMR Xhemajl Ahmeti, përfaqësues i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti, dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinate - Natasa Prica-Tishma, zyrtare e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Živković**, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.05.2013;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-170 për transplantimin e organeve, me raport dhe amandamente të Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, me raport dhe amandamente të Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-167 për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të pronës, me raport rekomandim të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion;**

6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale, me raport dhe amandamente të Komisionit Funkcional për Legjislacion;**
7. **Të ndryshme.**

Kryesuesja - konstatoi se janë krijuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me propozim që pika e rendit të ditës, në të ndryshme, të plotësohet me rekomandimin e miratuar në mbledhjen plenare më 7 dhe 13 qershor, për mbikëqyrjen e Strategjisë së Qeverisë së Kosovës për Integrimin e komunitetit, Romë, Ashkali edhe Egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015, dhe e njëjta u miratua nga anëtarët e komisionit.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja, konsideron se rendi i ditës u miratua me propozimin e lartcekur, ndërsa pikat tjera u miratuan, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Kryesuesja - konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtura më 28.05.2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-170 për transplantimin e organeve, me raport dhe amandamente të Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;

Kryesuesi- paraqet për shqyrtim Projektligjin nr. 04/L-170 për transplantimin e organeve dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandim i cili do t'i dërgohet Komisionit Funkcional.

Albert Kinolli, e njoftoi Komisionin se ka informatë, me kërkesë të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë është tërheq Projektligji për transplantimin e organeve andaj për këtë arsye kërkoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për shqyrtim në njërin nga mbledhjet e radhës.

Kryesuesja, tha se Komisioni paraprakisht nuk është informuar se Qeveria ka bërë tërheqjen e Projektligjit për transplantimin e organeve, andaj nuk është pengesë që Komisioni të shqyrtojë projektligjin për procedim të mëtejme.

Glauk Konjufca, ai ceku se e ka marrë të njëjtën informatë nga anëtari i GV i cili njëherit është anëtar i komisionit për shëndetësi, se Ministria për Shëndetësi ka bërë tërheqjen e Projektligjit për transplantimin e organeve. Dha sqarim se komisioni funksional ka pasë diskutime të një pasnjëshme rreth amandamentimit të projektligjit andaj Ministria përkatëse e ka parë të arsyeshme tërheqjen e tij.

Nuk e sheh të arsyeshme të shqyrtohet projektligji për derisa Ministria përkatëse të bjen propozimin me tekst final.

Petar Miletic, ai tha se mund të diskutohet çështja e ngritur nga zot, Albert. Mirëpo, veçoi se Komisioni nuk ka informatë të shkruar formale për tërheqje të projektligjit nga Qeveria. Ai mendon se nuk do të paraqet pengesë që komisioni të procedojë raportin e komisionit funksional, në ndërkohë, komisioni do të përfill edhe procedurat e mëtejme të komisionit funksional.

Lidhur me këtë çështje, ai konsideron se komisioni do të dalë me rekomandim konkret se raporti i komisionit funksional nuk shkel të drejtat e komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Mursel Halili, , Duke u nisur nga fakti se mungon shkresa formale e Ministrisë përkatëse për tërheqjen e Projektligjit për transplantimin e organeve, ne mund të bazohemi në informatën e besueshme të kolegëve. Andaj, u ndërlidh se nuk e sheh të arsyeshme të votohet një Projektligj, i cili është tërhequr.

Lumnije Morina – sa i përket procedimit të shqyrtimit të projektligjeve, si komisioni i përhershëm vlerësojmë se Projektligji nuk prek dhe nuk cenon të drejtat e komuniteteve. Në anën tjetër shprehu shqetësimin e saj për mënyrën e procedimit, pasi mungon shkresa e Qeverisë për tërheqje të projektligjit, andaj kërkoi që kryesuesja të marr qëndrim të prerë si të procedohet më tej.

Albert Kinolli, pas diskutimeve të shumta ai sërish ishte i mendimit që komisioni të mos shqyrtojë Projektligjin për transplantimin e organeve, pra deri në marrjen formale për ndryshim dhe plotësim nga ana e Ministrisë përkatëse, gjegjësisht deri në marrjen e raportit përfundimtar të komisionit funksional për shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kryesuesja, theksoi se Raporti me amandamente i komisionit funksional në Projektligjin nr.04/L-170 për transplantimin e organeve nuk paraqet shkelje dhe cenim të të drejtave dhe interesave të komuniteteve, andaj të njëten e hodhi në votim.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, me pesë vota për dhe katër abstenim, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr.04/L-170 për transplantimin e organeve dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
 - II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, me raport dhe amandamente të Komisionit Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**

Kryesuesi- paraqet për shqyrtim Projektligjin nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe kërkoi që komisioni të deklarohej nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandim i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Me që nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, me tetë vota për dhe një kundër, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- III. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- IV. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-167 për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të pronës, me raport rekomandim të Komisionit Funkcional për Legjislacion

Kryesuesja, paraqet për shqyrtim Projektligjin nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti r. 04/L-167 për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të pronës, dhe kërkoi që komisioni të deklarohej nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandim i cili do t'i dërgohet Komisionit Funkcional.

Kryesuesja, në fjalën e saj tha se komisioni funksional për Legjislacion ka dalë me Rekomandim që Kuvendi të mos miratoi Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të pronës, të bazuar në mospajtim me amandamentimin 22, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe bazuar në nenin 5 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve, që kanë të bëjnë me ndryshimin e mbikqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës

Ajo ceku se është bërë leximi i parë i Projektligjit në Parlament, dhe i njëjti duhet të procedohet për lexim të dytë.

Duke u nisur nga të arritura e bisedimeve Prishtinë – Beograd, rrjedh vet fakti se rezultatet e bisedimeve janë marrëveshje që të mbrohen të drejtat dhe interesat e qytetarëve të Kosovës.

Petar Miletic, ndonëse ekziston rekomandimi formal të votuar nga komisioni për legjislacion, që ka qenë 50 me 50, por vota e kryetarit ka mundur mosmiratimin e Projektligjit, ndërsa qëndrimi i tij ishte që të hidhet poshtë rekomandimi i komisionit për legjislacion.

Ai u ndërlidh që mosmiratimi i këtij projektligji do të shkaktojë shtyrje e afatit për formimin e agjencisë për planifikim të pronës. Sa i përket kësaj çështje, një numër i madh i përkatësive etnike ballafaqohet me probleme të mëdha.

Me që është arritur marrëveshja në mes Prishtinës dhe Beogradit, duhet të lehtësohet mundësia për verifikim të pronës. U ndërlidh se kjo çështje kërkon qëndrim politik andaj pajtohet me kryesuesen që të mos përfillen rekomandimet e komisionit funksional.

Kryesuesja, propozoi që komisioni të përkrah Projektligjin e propozuar nga Qeveria, ndërsa të mos përkrahet raporti me rekomandime të komisionit funksional.

Pas diskutimeve të anëtarëve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, me tetë vota kundër dhe një abstenim, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji për Agjencinë kosovare për krahasim dhe verifikim të pasurisë është me rëndësi për komunitetet dhe nuk i lëndon dhe rrezikon të drejtat dhe interesat e tyre.
2. Komisioni i shqyrtoi rekomandimet e propozuara të Komisionit funksional për Legjislacion dhe të njëjtat nuk i ka përkrahur për t'ia kthyer propozuesit.
3. Komisioni konstatoi se i njëjti nuk i lëndon dhe rrezikon të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe Kuvendit i rekomandon ta miratojë Projektligjin në tërësi, versionin e punës së propozuesit.

A r s y e t i m

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 26.06.2013, e shqyrtoi Projektligjin për Agjencinë kosovare për krahasimin dhe verifikimin e pasurisë me rekomandimet e Komisionit funksional për Legjislacion dhe të njëjat nuk i ka përkrahur për t}ia kthyer propozuesit, sepse projektligji ka për qëllim respektimin e të drejtave të të gjithë qytetarëve të Kosovës, në rastet e zgjedhjes së kërkesave që kanë të bëjnë me pasurinë private bujqësore dhe komerciale.

6. Të ndryshme;

Albert Kinolli – tha se pas debatit parlamentar, të mbajtur më 7 qershor 2013, lidhur me strategjinë e Qeverisë së Kosovës për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015, dhe bazuar në kërkesën e deputetit Xhevdet Neziraj, është miratuar Rekomandimi nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ai konsideron se rekomandimi bie në kundërshtim me strategjinë e Qeverisë, Njëherit propozoi që në një takim të komisionit të ftohet zot, Neziriri i cili do të ofrojë opinionet e tij lidhur me këto rekomandime.

Bazuar në çështjen e ngritur, Komisioni për të Drejta dhe Interesa të Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Përfundim

Në pajtim me rekomandimet e Kuvendit, Grupi Punues i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim për mbikëqyrjen e Strategjisë së Qeverisë së Kosovës për Integrimin e komunitetit, Romë, Ashkali edhe Egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015, kërkoi që Qeveria në formë të informatës zyrtare, ta informoi Komisionin nëse është kryer plotësimi dhe ndryshimi i kësaj strategjie.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Živković